



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.105/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes së posterave në shtylla elektrike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Lipjan, ZL.Anr.105/2017, të datës 01.10.2017, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1.650,00 (njëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datën 01.10.2017, në rrugën “Ajet Kozhani” dhe në rrugën “Vehbi Kozhani” në fshatin Ribar i Madh të Komunës së Lipjanit, në shtylla elektrike ishin të vendosur postera të kandidatit për kryetar të Komunës së Lipjanit.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 4.1 pikës b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Me propozim për panelin që të merren masa ndëshkuese ndaj subjektit politik LDK-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur tri (3) fotografi, lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2017, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka theksuar se ankesa është e pabazuar, për faktin se jemi në kohë fushate, dhe se në mungesë të hapësirave të cilat komunat kanë obligim ligjor ti krijojnë për kohë fushate për subjektet politike dhe kandidatët e tyre atëherë vendosja e përkohshme e posterave në shtyllat elektrike të fshatit të cilin po vizitohej atë ditë kandidati për kryetar nuk do të duhet të trajtohet si shkelje e nenit 33 të LZP-së e as rregullave zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur katër (4) fotografi me të cilat shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoj se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se posterat e kandidatit për kryetar të Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, nga radhët e subjektit politik LDK, janë vendosur në shtylla elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte apo në hapsira publike”*.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të Komunës së Lipjanit, nga radhët e subjektit politik LDK, janë vendosur në shtylla elektrike.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, ngase subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në objekte dhe në hapësirë publike. Po ashtu, si rrethanë Paneli e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i njëjti ka tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.105/2017 më datën 03.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Prishtinë / Prishtina

Lejtoni Panel Za Zabe / Prishtina

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.